



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE**

Numri i Ceshtjes : 31154-03486-80-2021      Data e Regjistrimit : 10/06/2021  
Numri i Vendimit: 80-2021-2650      Data e Vendimit : 28/09/2021

**VENDIM**

**NE EMER TE REPUBLIKES**

**GJYKATA E ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE TIRANE E PERBERE NGA:**

GJYQTAR: {...}

SEKRETARE: {...}

Sot me date 28/09/2021mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore geshtjen civile qe i perket :

**Padites Shoqeria tregtare {...} SH.P.K I Paditur DREJTORIA E PERGJITHSHME E PRONESISE INDUSTRIALE**

**Objekti:1.Shfuqizimi i aktit administrativ - vendimit nr. 145/17, date 04.03.2021 te Bordit te Apelit te Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale (“DPPI”) dhe aktit administrativ - vendimit nr. 145/9, date 03.06.2020 te Dhomes Per Shqyrtimin e Kundershtimeve te DPPI-se; 2.Detyrimin e Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale qe te regjistroje marken {...} me numer kerkese AL-T- 2019-145 ne regjistrin e markave tregtare; 3.Shpenzimet gjyqesore, duke perfshire shpenzimet ligjore ashtu sig jane here, t’i ngarkohen te Paditurit.**

**Baza Ligjore:Nenet 7, 10, 11, 15, 17, 18 dhe 37 te ligjit nr. 49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative” Nenet 4, 13, 14, 20, 48, 109, 113 dhe 114 te ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikes se Shqiperise” Nenet 143 dhe 184/\$ te Ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 “Per Pronesine Industriale” (i ndryshuar) Neni 8 i Konventes se Parisit perMbrojtjen e Pronesise Industriale**

Paditesi, shoqeria tregtare {...} sh.p.k, nepermjet perfaqesuesve Av.Elton Peppo dhe Av.Myzejen Lengo:

Pranimin e kerkesepadise.

Pala e paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, nepermjet perfaqesueses Znj.Milena Memsuri:

Rrezimin e kerkesepadise.

Personi i trete shoqeria {...} S.P.A, nepermjet perfaqesueses Av.{...}:

Rrezimin e kerkesepadise.

Gjykata, si shqyrtoi aktet dhe e bisedoi ne teresi geshtjen.

**VEREN :**

Paditesi shoqeria tregtare {...} sh.p.k, i eshte drejtuar me kerkesepadi Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, duke kerkuar sipas objektit.

Gjykata, ne mbeshtetje te nenit 7 germa "a" 10/1, dhe 11/1 te ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" i ndryshuar, dhe 36 te Kodit te Procedures Civile, kryesisht konstaton se eshte kompetente nga pikepamja lendore dhe tokesore per gjykimin e kesaj geshtje dhe se mosmarreshja ne fjale ben pjese ne juridiksionin gjyqesor. Per te bere te mundur mbrojtjen dhe perfaqesimin e interesave te shtetit ne kete gjykim, ne zbatim te nenin 79/a te K.Pr.Civile, kerkesepadia dhe aktet iu njoftuan Avokatures se Shtetit, Zyra Vendore Tirane, e cila ndonese rezulton te jete njoftuar rregullisht per gdo seance, pa ndonje shkak te arsyeshem nuk u paraqit.

•~~€€€€€€€€~~ Rrethanat e geshtjes:

Shoqeria {...} sh.p.k, eshte nje shoqeri tregtare e themeluar dhe e organizuar sipas te drejtes se Republikes se Kosoves, e cila operon ne fushen e prodhimit dhe tregtimit te kafes, gajit, farerave pelenave dhe artikujve te tjere te ngjashem. Ne kluader te ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar, shoqeria {...} prodhon dhe tregton te gjitha artikujt e saj nen emrin e regjistruar te shoqerise {...}.

Per kete arsye, paditesi ka krijuar familjen e tij te markave tregtare {...} ne Kosove, dhe me pas ne Shqiperi ku jane regjistruar nje numer i konsiderueshem markash nen kete element sipas llojit dhe natyres se produkteve/mallrave te mbrojtura, duke perfshire marken "{...} cafe", per produktet e kafes, marken "{...} cikjo" per produktet e farerave dhe marken "{...} baby diapers" per pelena per femije.

Bazuar ne te njejten logjike ekonomike dhe strategji marketingu, si dhe ne perputhje me markat e regjistruara ne Kosove, paditesi me date 11.02.2019, ka aplikuar prane DPPI per regjistrimin e disa markave, ku nder te tjera ka aplikuar dhe per regjistrimin e markes tregtare "{...} cafe" (AL-T-2019-145) ne klasat 30 dhe 35 te klasifikimit te Nices, per kafe dhe produktet e kafes, marke e cila eshte kundershuar nga shoqeria "ESSSI CAFFE" S.P.A (personi i trete) ne kete gjykim.

Ne vijim te ekzaminimit per shkaqe absolute dhe publikimit te markes "{...} cafe" ne Buletinin e Pronesise Industriale nr.10/2019, date 08.05.2019, kundershuesi, shoqeria {...}S.P.A, pronare e markes se meparshme "{...} 1228929), bazuar ne nenet 143 dhe 152 te ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "Perpronesine industriale" i ndryshuar, ka depozituar prane Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve te DPPI-se kerkesen per refuzimin e regjistrimit te markes se publikuar {...} sh.p.k, me numer aplikimi AL-T-2019-145, me pretendimin se marka {...} e aplikuesit nuk mund te regjistrohet sepse eshte e ngjashme me marken e meparshme {...} te kundershuesit dhe eshte regjistruar per te njejtat mallra, duke sjellur mundesine e shkaktimit te konfuzionit tek publiku.

Ne perfundim te procedures administrative, si dhe pas shqyrtimit te pretendimeve perkatese te paleve, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve me vendimin nr.145/9 prot., date 03.06.2020, ka vendosur: *Pranimin e kundershimit te regjistrimit te markes {...} me numer aplikimi AL-T-2019-145, me aplikant {...} sh.p.k, dhe refuzimin e regjistrimit te saj.*

Ky vendim i Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve eshte kundershuar nga paditesi shoqeria {...} sh.p.k, prane Bordit te Apelimit.

Bordi i Apelimit prane DPPI-se, me vendimin nr.145/7 prot., date 04.03.2021, ka vendosur:

1. *Refuzimin e e kerkeses per apelimin e vendimit nr.145/9 prot., date 03.06.2020 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve.*
2. *Refuzimin e kerkeses per regjistrimin e markes me emertim {...}me nr.aplikimi AL-T-2019-145.*

Nisur sa me siper, paditesi shoqeria {...} sh.p.k, i eshte drejtuar me kerkesepadi gjykates, duke kerkuar, sipas objektit.

•~~€€€€€€€€~~ Pretendimet e paleve:

Paditesi:

Ne kerkesepadine e paraqitur per gjykim si dhe gjate gjykimit, si dhe nepermjet parashtrimeve te paraqitura gjate gjykimit, nga pala paditese ne menyre te permbledhur eshte pretenduar si me poshte:

1. Vendimi i Bordit te Apelimit, ashtu sikurse ai i Dhomes, duhet te shfuqizohen per shkak se jane nxjerre ne shkelje te dispozitave lidhur me proceduren dhe elementet e detyrueshem qe duhet te permbaje nje akt administrativ. Vendimi i Dhomes dhe i Bordit te Apelimit eshte i bazuar duke marre ne konsiderate vetem pretendimet/provat e paraqitura nga kundershuesi, si dhe nuk kane marre nje vendim mbi te gjitha geshtjet e ngritura nga pala e kundershuar. Ne emnyre te vegante, Dhoma nuk ka vlersuar pretendimet apo provat e shoqerise {...} mbi emrin tregtar, ekzistencen e familjes se markave {...} dhe faktin se marka e kundershuar eshte aplikuar nen shenjen dalluese dhe emrin e regjistruar te shoqerise {...} sh.p.k.

2. Ne kundershim me nenin 20 te ligjit nr.44/2015, Dhoma dhe Bordi i Apelimit kane pranuar si te vlefshme provat e paraqitura ne gjuhe te huaj nga personi i trete gjate procedurave administrative.

3. Bordi i Apelimit ka perfunduar proceduren administrative pa vendosur per te gjitha geshtjet e ngritura nga palet gjate procedures dhe qe nuk kane marre zgjidhje gjate tij. Akti administrativ i kundershuar nuk permbush as kerkesat formale te nje akti administrativ per sa kohe nuk eshte i arsyetuar ne menyren e kerkuar nga ligji, e konkretisht nga neni 100 i ligjit nr.44/2015. Arsyetimi i vendimit te Bordit te Apelimit kufizohet vetem ne tre paragrafe qe shprehin thjesht dakortesine me vendimin e Dhomes. Vendimi nr.145/17, date 04.03.2021 i Bordit te Apelimit nuk permban ne asnje moment nje shpjegim te permbledhur mbi rezultatin e hetimit administrativ dhe vlersimin e provave te dy paleve.

4. Vendimi i Bordit te Apelimit dhe vendimi i Dhomes jane marre ne kundershim me ligjin material nr.9947/2008. Analiza e ngjshmerise midis markave ne konflikt realizohet duke u bazuar mbi teresine e elementeve perberes te markave dhe ne pershtypjen e pergjithshme qe ato shkaktojne tek konsumatori, duke u fokusuar ne elementet dominante dhe dallues te markes. Ne kundershim nga sa pretendohet nga kundershuesi dhe ne kundershim me vendimin e Dhomes/Bordit te Apelimit, elementet dominant dhe dallues tek markat ne konflikt nuk jane vetem elementet fjale "ESSSE" dhe {...}.

5. Dhoma dhe Bordi i Apelimit kane gabuar ne inteprtetimin e ligjit material dhe zhvillimin e analizes krahasuese te ngjshmerise se markave ne aspektin vizual per shkak se krahasimi vizual eshte bazuar kryesisht tek elementet "{...} dhe {...}, pavarsisht se keto elemente nuk perbejne elementet e vetem dallues te markave, ndersa eshte e qarte se keto elemente nuk jane te vetmit elemente dominant te markave ne konflikt. Krahasimi vizual nuk eshte bazuar ne teresine e elementeve perberes te markave dhe pershtypjen e pergjithshme qe markat shkaktojne tek konsumatorete. Dhoma dhe Bordi i Apelimit i konsiderojne markat ne konflikt si vizualisht te ngjshme per shkak se elementet e tyre perberes jane te ngjashem. Markat ne fjale nuk jane aq te ngjashme ne teresine e tyre sa per te shkaktuar konfuzion ne rradhet e konsumatoreve. Markat duhet te krahasohen ne teresine e elementeve perberes te tyre, duke u fokusuar ne elementet dominant dhe dallues te tyre. Ne aspektin vizual marka e kundershuar karakterizohet nga paraqitja e stilizuar e elementit {...}, qe rrethohet nga vijezime te gjata me ngjyra te ndryshme; e kuqe, e bardhe, dhe ngjyre ari. Gjithe pamja e markes paraqitet ne nje paketim me sfond me ngjyra te zeze, ku figura e nje filxhani kafeje (i mbushur me kafe) me disa kokrra kafeje te pabluara ne pjate dhe nje mori kokrrash kafeje te pabluara. Nga ana tjetere marka kundershuese konsiston ne paraqitjen e stilizuar te elementit dallues {...}ne brendesi te nje figure elipsi me ngjyre gri, ku stilizimi i vegante i germes "S" ne formen e kokrrave te kafes terheq plotesisht vemendjen e konsumatoreve dhe mbetet ne vemendjen e tyre duke sherbyer ne kete menyre edhe per identifikimin e origjines tregtare te mallrave. Elementet e tjere jo dallues "CAFFE" dhe {...} plotesojne pamjen e markes dhe nuk paraqesin rendesi te madhe ne krahasimin e markave, megjithse elementi {...} (pavarsisht karakterit pershkruar jo dallues) sherben per te identifikuar origjinen tregtare te mallrave dhe ben te mundur

dallimin me marken e kundershtuar lidhur me kete fakt: kafe ekspres me origjine nga Italia dhe kafe turke me origjine nga Kosova.

6. Ne aspektin konceptual markat jo vetem qe nuk mund te krahasohen, por rezulton se ato jane krejtesisht te ndryshme dhe sherbejne per te identifikuar origjinen tregtare te mallrave te tyre tek konsumatoret. Ne kundershtim me interpretimin e Dhomes dhe Bordit te Apelimit sipas te cilit markat nuk mund te krahasohen ne aspektin konceptual sepse elementet literal te markave jane fjale qe nuk mbartin ndonje kuptim te vegante ne gjuhen shqipe, marka e kundershtuar percjell tek konsumatoret kuptimin dhe idene e mallrave te kafes turke te tregtuara nga shoqeria {...} nen marken e saj {...}. Nga ana tjetere, elementet literal perberes te markes kundershtuese ne teresine e saj {...} krijon lidhje te drejtperdrejte me konsumatorin dhe percjell tek keta te fundit idene e mallrave te kafes ekspres te tregtuar nga shoqeria {...} S.P.A. Pra mundesi per konfuzion midis markave ne fjale perjashtohet qofte dhe vetem mbi kete fakt.

7. Ne aspektin fonetik, markat {...} dhe {...} shqiptohen dhe tingellojne ne menyra te ndryshme. Prania e perseritur e germen "S" tek marka kundershtuese ({...}) percakton ne menyre te ndjeshme shqiptimin dhe tingellimin e markes nga ana e konsumatoreve, duke u dalluar nga leximi, shqiptimi dhe tingellimi i markes {...}. Ne menyre te vegante, diferenca e shkronjave "S" (duke perfshire ketu jo vetem "ESSSE" por edhe germen "S" shtese ne formen e kokrrave te kafese) perfocon edhe me tej dalluesmerine ne shqiptimin dhe tingellimin midis markave. Shqiptimi i markes kundershtuese nga ana e konsumatoreve do te zgjatet ne menyre te konsiderueshme me germen "S" ne ndryshim nga marka e kundershtuar. Pavarsisht ngjashmerise identike te mallrave dhe sherbimeve te tjera midis markave theksojme se nuk mund te flasim per mundesi te krijimit te konfuzionit per aq kohe sa markat jane te ndryshme ne aspektin vizual, fonetik dhe konceptual.

Pala e paditur:

Nepermjet prapesimeve te paraqitura gjate gjykimit, pala e paditur dhe personi i trete, ne menyre te permbledhur prapesuan kerkimet e pales paditese si me poshte:

#### Pala e paditur Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale:

1 Analiza e krahasimit te markave ne konflikt eshte realizuar duke u bazuar mbi teresine e elementeve perberes te markave dhe ne pershtypjen e pergjithshme qe shkatojne ato tek konsumatori, duke u fokusuar ne elementet dominante dhe dallues te markes.

2. Nga pikepamja vizuale, marka e kundershtuar dhe marka kundershtuese jane vizualisht te ngjashme per arsye se elementet perberes te tyre jane te ngjashme, pasi marka e kundershtuar perbehet nga paraqitja ne menyre te stilizuar e elementit literal {...} e shkruar me germa ne ngjyre te bardhe. Ne pjesen e poshteme te saj paraqitet elementi grafik i stilizuar i nje filxhani kafeje dhe te kokrrave te kafese. E gjitha marka konsiston ne formen e paketimit te nje qeseje kafeje. Marka kundershtuese perbehet nga paraqitja ne menyre te stilizuar e elementit literal {...} e shkruar me germa ne ngjyre te bardhe te vendosura brenda figures se nje elipsi. Ne pjesen e fundit te saj jane paraqitur ne menyre te stilizuar elementet literal {...} te shkruajtura me ngjyre te bardhe. Per sa me siper, elementet literal te markes ne procedure kundershtimi dhe elementet literal te markes kundershtuese, jane vizualisht shume te ngjashme e cila konsiston ne menyren e stilizimit dhe paraqitjes se tyre. Gjithashtu, karakteri dallues i markave ne diskutim qendron tek elementi verbal ESSSE vs. {...}. Per shkak se markat ne konflikt operojne ne fushen e kafes dhe te produkteve me baze kafe, elementet figure si kokrrat e kafese, filxhani i kafes, silueta e aromes se kafese qe ndodhen tek aplikimi i kundershtuar, apo fjalet CAFFE, ESPRESSO IN ITALY tek marka e meparshme jane element te dobet te markave pasi ato jane te nje natyre pershkruese. Elementi dominant dhe dallues i markave eshte elementi literal {...} dhe "Essse", te cilet perbejne elementin e vetem dominant te markave ne fjale. Per kete arsye, analiza e ngjashmerise ndermjet markave do te realizohet dhe bazohet vetem mbi kete element. Nga ana vizuale, markat objekt krahasimi jane te ngjashme midis tyre. Keshtu, te dy markat ne konflikt permbajne tre germa identike te cilat jane vendosur sipas te njejtij rend {...}dhe {...}. Ivetmi ndryshim eshte ne fund te tyre, por ky ndryshim eshte tejet i vogel dhe i paperfillshem ne pershtypjen e pergjithshme qe keto marka shkatojne tek konsumatori.

3. Nga pikepamja fonetike, markat jane te ngjashme pasi ngjashmeri midis fjaleve rezulton nga ngjashmeri midis shkronjave te perbashketa, por edhe ne teresine e shqiptimit/tingellimit/degjimit ndermjet tyre.

4. Ngjashmeria ndermjet mallrave per te cilat mbrohen markat ne konflikt: Aplikanti ka kerkuar mbrojtjen e markes per mallrat e klasave 30 dhe 35 te klasifikimit nderkombetar te Nises, per te cilat ishte regjistruar tashme marka kundershtuese. Per kete arsye, si dhe te ngjashmerise se larte vizuale dhe fonetike midis markave, si dhe bazuar ne njellojshmerine e mallrave te tyre, ekzistenca e mundesise se shkaktimit te konfuzionit eshte e pamohueshme dhe prezumohet vetvetiu, duke sjelle ne menyre te paevitueshme edhe bashkelidhjen midis markave, duke qene se mallrat e tyre jane te njejta dhe i perkasin te njejtij sektor te tregut, ate te produkteve te kafese.

5. Ne aspektin konceptual, jane analizuar elementet fjale dhe figure te markave, sepse konsumatori ne rastin kur marka eshte kombinim i elementeve figurativ me elementet fjale, ne pjesen dominuese e identifikon marken me emertimin e saj. Elementet literal te te dyja markave jane fjale te cilat ne gjuhen shqipe apo te perkthyer ne gjuhen shqipe, nuk mbartin ndonje kuptim te vegante, ndaj ato nuk mund te krahasohen konceptualisht.

6. Duke u bazuar ne analizen e mesiperme te detajuar te ngjashmerise, ekziston nje ngjashmeri e mjaftueshme ndermjet markes se kundershtuar dhe asaj kundershtuese, e tille qe te sjelle mundesine e konfuzionit ose e bashkelidhjes se tyre nga konsumatori. Kjo e fundit sjell me vete objektivisht rrezikun e shkaktimit te konfuzionit mbi origjinen e mallrave me keto marka ne publik. Konsumatori, mund te mendoje se mallrat dhe/ose sherbimet qe mbajne markat ne fjale, vijne nga e njejta kompani ose se te dyja ndermarrjet kane lidhje ekonomike me nje tjetren. Konsumatori me vemendje mesatare i cili nuk do te kishte ne vemendje te tij njekohesisht te dyja markat, mund te mendoj se eshte fjala per te njejtin marke.

Personi i trete shoqeria {...}sh.p.k.:

1 Paditesi e justifikon prezencen e elementit te perbashket {...} me pretendimin se ky eshte pjese e emrit tregtar te regjistruar ne Kosove, dhe rregullat per etiketimet parashikojne vendosjen e emrit te pronarit ne etikete, aplikanti ka formuar familjen e markave {...}, apo se neni 8 i Konventes se Parisit date 20 Mars 1883 "Per mbrojtjen e pronesise industriale" parashikon mbrojtje per emrat tregtare etj. Nje gje e tille nuk qendron, pasi Konventa e Parisit aplikohet mes vendeve anetare te Bashkimit Evropian, ne te cilin Kosova nuk ben pjese. Duke mos qene pjese e Bashkimit/Unionit, Kosova, e per rrjedhoje te gjitha subjektet tregtare te themeluara ne baze te ligjeve te Kosoves nuk e gezojne kete te drejte. Pra, neni 8 i Konventes se Parisit nuk eshte i aplikueshem ne rastin konkret. Edhe sikur ta pranonim per nje moment se Konventa e Parisit gjen zbatim ne rastin konkret, marka jone mbetet po perseri e drejte e meparshme dhe ndaj emrit tregtar {...} ne Kosove, pasi marka jone eshte e regjistruar ne Shqiperi qe prej dates 21.03.2014 dhe prezente ne tregun shqiptar qe prej vitit 2007, ndersa emri tregtar {...} figuron i regjistruar ne Kosove vetem me 08.10.2014, pra 7 (shtate) muaj me vone. Ne keet menyre, marka jone figuron e drejte e meparshme dhe ndaj regjistrimit te emrit tregtar {...} ne Kosove.

2. Pretendimi i aplikantit se ne nuk kemi provuar perdorimin markes tone eshte i pabazuar, pasi per qellime te provuarit te importeve tona ne Shqiperi, kemi depozituar shkresen nr.495/1 prot., date 21.01.2020 leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, si dhe flete nga bilanci i shkembimeve tregtare te mbajtura nder vite, ku me ane te te cilave provuam se tregtimi ne Shqiperi i produkteve nen marken {...}, ka filluar qe prej vitit 2007, nepermjet distributorit tone, shoqeria "Grand" sh.p.k. Provat e depozituara nga ana jone ne proceduren e mbajtur para Dhomes, permbushin te gjitha formalitetet e parashikuara nga ligji, ato provojne gjithashtu

perdorimin e gjate dhe intensive te markes tone duke filluar prej vitit 2007, dhe rrjedhimisht karakterin e theksuar dallues te markes tone {...}. Shkak ligjor baze mbi te cilein kemi mbeshtetur kundershimin tone ndaj markes {...} eshte mundesia per konfuzion. Ky shkak ligjor nuk kerkon te provuarit detyrimisht te perdorimit te markes ne territorin shqiptar, sipas nenit 143/2, germa "b" te ligjit specifik. Mundesia per konfuzion ekziston kur permbushen njekohesisht dy kushte: 1) Ngjashmeria mes shenjave, duke mbajtur parasysh karakterin dallues dhe dominant te tyre; 2) Ngjashmeria mes mallrave/sherbimeve. Te provuarit e ketyre dy kushteve, nuk eshte e lidhur me te provuarit e perdorimit te markes ne territorin shqiptar. Perdorimi i markes ne treg eshte thjeshte nje element shtese/dytesor i cili mund te kontribuojne ne krijimin e konfuzionit, gjithsesi nuk eshte element qe kerkohet detyrimisht te permbushet.

3. Sa i perket ngjashmerise se markave ne aspektin konceptual, Dhoma me te drejte ka vlersuar se markat nuk percjellin ndonje kuptim tek konsumatori, pasi {...} dhe {...} cafe, jane bashkime arbitrare shkronjash, keshtu qe krahasimi konceptual nuk merr rendesi. Ne rastin ne diskutim, elementet verbal {...} vs dhe {...} nuk kane ndonje kuptim te caktuar, nuk gjenden as ne fjalor apo enciklopedi, per pasoje nuk mbartin ndonje kuptim te caktuar. Aspekti konceptual ne rastin konkret eshte i rendesise zero, per pasoje nuk influencen ne vlersimin e pergjithshem te mundesise per konfuzion.

4. Nga pikepamja fonetike markat jane pothuajse identike. Diferenca e vetme ne shqiptim {...} vs. {...} Caffe, mund te mos vihet re pasi ato jane te dyja zanore te perparme, shqiptimi i te cilave kerkon te njejtin impenjim te gjuhes, p.sh, trupi i gjuhes shtyhet perpara, ndersa pjesa e mesme e shpines se gjyhes ngrihet drejt qiellzes se forte. Per me teper, ato humbasin ne morine e shkronjave qe shenjat/markat kane {...} vs. {...} Caffe. Vlen te theksohet se aspekti fonetik merr nje rendesi te vegante po te mbajme parasysh menyren e tregtimit te produkteve ne diskutim. Kafeja ne pergjithesi konsumohet ne bare kafe, ku porositet duke u thirrur dhe jo duke u shkruar. E ne nje suate te tille porosia per nje ekspres {...} lehtesisht mund te ngaterrohet me nje {...} Caffe.

5. Ne lidhje me aspektin vizual, krahasimi duhet te bazohet ne pershtypjen e pergjithshme qe markat percjellin, duke mbajtur parasysh komponentet dallues dhe dominant te tyre. Ne rastin ne diskutim karakteri dallues i markave qendron tek Essse vs. {...}. Per shkak se markat mbulojne kryesisht kafe dhe produkte me baze kafe, elementi figure si kokrrat e kafese, filxhani i kafese, silueta e aromes se kafese qe ndodhen tek aplikimi i kundershuar apo fjalet {...} tek marka e meparshme, jane element te dobet te markave pasi ato jane te nje natyre pershkruese. Essse vs. {...}, jane elementet me dominant te markave, pasi raporti i tyre tek marka/shenja respektive (ne krahasim me element te tjere) eshte me i madh dhe keto element pothuajse gjenden ne qender te markave. Per sa me siper krahasimi i markave/shenjave duhet te fokusohet tek karakteri dallues dhe elementet dominant te markave qe jane Essse vs. {...}. Dhe duke mbajtur parasysh kete kriter lehtesisht mund te konkludohet se markat ne dislutim ndajne ngjashmeri vizuale te konsiderueshme.

6. Ne lidhje me ngjashmerine e mallrave, ne rastin konkret mallrat dhe sherbimet jane ato te klasave 30 dhe 35, pasi rezulton se markat ne konflikt mbulojne pikerisht keto mallra, me perjashtim te markes kundershuese qe mbullon dhe klasen 43. Mallrat dhe sherbimet ne rastin ne diskutim jane identike. Ato koingidojne ne termat si; kafe artificiale, sherbime te shitjes me pakice te kafese dhe kafese artificiale etj., g'ka i ben ato identike.

7. Ne vlersimin e mundesise per konfuzion duhet mbajtur parasysh edhe shkalla e vemendjes se konsumatorit, mesatare e cila mund te ndryshoje ne varesi te mallrave dhe sherbimeve qe markat mbulojne. Ne qofte se ka nje nivel te vogel vemendje, ndryshimet midis markave padyshim nuk do te dallohen nga konsumatori, kjo per shkak te memorjes joprefekte te konsumatoreve. Anasjelltas, nje shkalle e larte vemendje do te minimizonte mundesine per konfuzion, pasi konsumatori per shkak te vemendjes do te diferenconte markat. Ne pergjithesi, nje shkalle e ulet vemendje eshte e lidhur ne menyre te vegante me zakonin e te berit pazar. Vendimet e blerjeve ne kete fushe kane te bejne me psh., mallra te lira te blera ne baza ditore. Kafeja dhe produktet me baze kafeje jane produkte qe konsumohen vazhdimisht dhe hyjne ne kategorine e produkteve me gmime te lira. Vendimi per blerjen/konsumin e tyre merret shpejt. E gjithë kjo rezulton ne nje shkalle te ulet vemendje e cila padyshim do te kntribuojne ne krijimin e konfuzionit, pasi ndryshimet/diferencat mes markave padyshim nuk do te dallohen nga konsumatori perkates.

8. Karakteri i theksuar dallues i markes se meparshme eshte nje tjeter element qe mbahet parasysh ne vlersimin e mundesise per konfuzion. Produktet e {...} tregtohen per nje kohe te gjate ne tregun shqiptar. {...} pa diskutim ka fituar karakter te theksuar dallues per shkak te emrit te mire dhe prezences se saj te gjate ne tregun shqiptar. Ky eshte nje tjeter faktor qe kontribuon ne mundesine per konfuzion. Per te mos mbetur vetem tek mundesi per konfuzion, qe gjithsesi perben baze te mjaftueshme per te refuzuar regjistrimin e markes se kundershuar, ne rastin ne diskutim prezente eshte gjithashtu dhe mundesia e bashkelidhjes se markave, nje shkak tjeter ligjor i parashikuar nga neni 143/2, germa "b" i ligjit specifik. Ne doktrinen e markave ky lloj konfuzioni ka te beje me origjinen tregtare te mallrave te cilat mbuloohen nga markat. Ky eshte rasti kur pronari i markes se kundershuar mund te preceptohet si i ligencuari/distributor i pronarit te markave kundershuese, apo mund te preceptohet si dege e kompanise (meme) te pronarit te markave kundershuese. Ne rastin ne diskutim, duke mbajtur parasysh se markat perkajne ne karakteret e tyre dalluese Essse vs. {...}, konsumatorët do t'i preceptojne markat si zgjatim te njera-tjetres, si marka/produkte qe derivojne nga e njejta familje markash. Dhe e gjitha kjo do te rezultojne ne ngaterrimin e origjines tregtare te produktit pasi konsumatorët do te mendojne qe produktet vijne nga e njejta sipermarrije apo sipermarrjet jane te lidhura me njera-tjetren. Per sa me siper, mundesia e bashkelidhjes se markes apo sig quhet ndryshe konfuzioni ne lidhje me origjinen tregtare ketu eshte prezent. Keshtu qe markes se kundershuar nuk duhet t'i jepet mbrojtje.

#### • Vlersimi i gjykates:

Ne lidhje me plotesimin e kushteve formale te padise:

Nje nga kushtet formale te paraqitjes se padise ne gjykimin e mosmarreveshjeve administrative eshte ajo e ezaurimit te rruges administrative te ankimit, si dhe ai i respektimit te afatit te paraqitjes se padise.

Sipas nenit 129 te ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative ne RSH", ligj ky qe ishte ne fuqi ne kohen e nxjerrjes se aktit administrativ, objekt gjykimi "Shterimi i ankimit administrativ, eshte kusht paraprak per ngritjen e padise ne gjykaten kompetente per geshtjet administrative, perveg rasteve kur"

a) ligji nuk ka parashikuar organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar drejtperdrejt ne gjykate;

c) organi me i larte ne shqyrtimin e ankimit administrativ ka cenuar, me vendimin e tij te drejtat apo interesat personale te ligjshem te nje personi, i cili nuk ka qene pale ne proceduren administrative.

Po ashtu, i njejtë parashikim ligjor, eshte parashikuar edhe ne ligjin e posagem nr. 49/2012 "Pergjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative" i ndryshuar, i cili ne nenin 16 pika 1 te tij, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti ti drejtohet gjykates.

Sipas pikes 2 te nenit 16 te ligjit te siperpermendur, perjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ me te larte per paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi me i larte administrativ nuk eshte konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht te drejten per t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtperdrejt ne gjykate;

c) organi me i larte ne shqyrtimin e nje ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, te drejtat apo interesat personale te ligjshem te nje personi, i cili nuk ka qene pale ne procedimin administrativ.

Ne lidhje me shterimin ose jo te ankimit administrativ, Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte me vendimin unifikues nr.1 date 26.11.2010, kane arritur ne perfundimin unifikues sipas te cilit: "Ndjekja e rruges administrative (te apelimit administrativ) per zgjidhjen e mosmarreshjes administrative perpara se subjekti t i drejtohet gjykates, eshte e detyrueshme vetem nese ligji qe rregullon marredhenien juridike dhe veprimtarine administrative te fushes perkatese, parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund te ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek te cilet eventualisht, sipas hierarkise, duhet te drejtohet apelimi administrativ".

Ligji i posagem nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" i ndryshuar, qe rregullon veprimtarine administrative ne fushen e mbrojtjes se te drejtave te pronesise industrial, i cili gjendet i zbatueshem per geshtjen objekt gjykimi, ne piken 3, te nenit 153/a, te tij ka parashikuar se: "Kunder vendimit te marre nga Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve mund te behet apelim ne Bordin e Apelit perkundrejt pageses se tarifes perkatese, brenda nje periudhe 1-mujore nga data e marrjes njoftim te vendimit."

Nga permbajtja e kesaj dispozite shihet qarte se ligji i posagem, nr. 9947, date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" i ndryshuar, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se te shkohet ne gjykate.

Referuar rastit ne gjykim, rezulton se ndaj vendimi te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve nr.145/9 prot., date 03.06.2020, shoqeria tregtare {...} sh.p.k, ka paraqitur ankim prane Bordit te Apelit te DPPI-se.

Bordi i Apelimit prane DPPI-se, me vendimin nr.145/7 prot., date 04.03.2021, ka vendosur:

1. Refuzimin e e kerkeses per apelimin e vendimit nr.145/9 prot., date 03.06.2020 te Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve.

2. Refuzimin e kerkeses per regjistrimin e markes me emertim {...}me nr.aplikimi AL-T-2019-145.

Nga sa me siper, rezulton e provuar se pala paditese ka konsumuar rrugen administrative te ankimit administrativ, te parashikuar nga neni 153/a, i ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "Perpronesine industriale" i ndryshuar, dhe se mosmarreshja objekt gjykimi ben pjese ne juridiksionin gjyqesor.

Ne lidhje me afatin e ngritjes se padise:

Ashtu sig u citua me siper, kusht tjetër formal per paraqitjen e padise, eshte ai i respektimit te afatit te paraqitjes se padise.

Ne nenin 18 pika 1 te ligjit nr. 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" (Afati per ngritjen e padise) thuhet se:

1. Padia kunder veprimit administrativ paraqitet ne gjykate brenda 45 diteve.

Ky afat fillon nga:

a) data e njoftimit, sipas menyres se percaktuar ne ligji, te aktit administrativ te organit epror, qe ka shqyrtuar ankimin administrativ;

Ne lidhje me afatet e parashkrimit legjislacioni yne parashikon dy kategori te afateve te parashkrimit; afate te pergjithshme dhe afate te posagme, ku afatet e pergjithshme jane me te gjata se afatet e posagme.

Afatet e pergjithshme te parashkrimit zbatohen per te gjitha kerkesat qe i shtrohen parashkrimit shues, kur per keto nuk eshte caktuar ne ligj nje afat i posagem parashkrimi.

Ashtu sig u citua me siper, afati i pergjithshem i ngritjes se padise per te kundershtuar nje akt administrativ, sipas nenit 18, pika 1 te ligjit nr. 49/2012, eshte 45 dite, afat ky qe fillon nga data e njoftimit te aktit.

Ligji i posagem nr. 9947, date 07.07.2008 "Perpronesine industriale" i ndryshuar, ne nenin 184/g te tij ka parashikuar se: "Kunder nje vendimi te Bordit te Apelit mund te behet ankim ne gjykatën kompetente brenda 45 diteve nga dita kur eshte marre njoftim per vendimin."

Referuar rastit ne gjykim, ne lidhje me njoftimin e Vendimit te Bordit te Apelimit nr.145/7 prpt., date 04.03.2021, nga pala paditese u pohua se ata jane vene ne dijeni te ketij akti me date 29.04.2021, ndersa kerkespadia eshte depozituar ne gjykate me date 10.06.2021. Nderkohe nga pala e paditur nuk u paraqit ndonje prove ne lidhje me njoftimin e ketij akti pales paditese. Duke iu referuar dates se marrjes dijeni per aktin nga pala paditese (29.04.2021) dhe dates se paraqitjes se kerkesepadise ne gjykate (10.06.2021) Gjykata, konstaton se kerkesepadia eshte paraqitur brenda afatit 45 ditor te parashikuar nga neni 184/g i ligjit specifik nr.9947/2008 dhe neni 18, pika 1 te ligjit nr.49/2012.

Ne lidhje me legjitimitimin e paleve:

Sipas nenit 32/a te K.Pr.Civile, padia mund te ngrihet:

a) per te kerkuar rivendosjen e nje te drejte ose interesi te ligjshem qe eshte shkelur.

Ne kuptim te kesaj dispozite progeduriale civile, qe te justifikohet ligjerisht kerkimi per njohjen ose rivendosjen e nje te drejte te shkelur ose te mohuar, kjo duhet te behet vetem prej atij qe i perket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej nje te treti (legjitimim aktiv) dhe vetem kundra atij qe me vepren e tij, mohon ose shkel te drejten e kerkuesit (legjitimim pasiv).

Interesi i ligjshem gjendet i pasqyruar dhe ne dispozita te tjera progeduriale qe rregullojne gjykimin e mosmarreshjeve administrative.

Keshtu sipas nenit 15 te ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative", te drejten e ngritjes se padise e ka:

a) gdo subjekt, qe pretendon se i eshte cenuar nje e drejte apo nje interes i ligjshem nga nje veprim apo mosveprim i organit publik;

Nga permbajtja e ketyre dispozitave progeduriale del se personi fizik apo juridik mund te kerkojne zgjidhjen e konfliktit administrativ nese plotesohen apo permbushen dy kushte:

Se pari; akti administrative duhet te jete i paligjshem.

Se dyti; paditesi te jete cenuar ne interesat e tij ne menyre te drejtperdrejte ose te terthorte.

Legjitimiteti i pales ne nje proges gjyqesor nenkupton interesin legjitim dhe te vertete qe duhet te ekzistojte ndermjet pales dhe geshtjes ne shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr.49/2012, e kondicionon te drejten e paditesit per te ngritur padi me interesin e ligjshem qe duhet te kete ai per njohjen ose rrezimin e nje pretendimi. Interesi i ligjshem lidhet me te drejten e pales per te kerkuar nepermjet gjykates njohjen ose rivendosjen e nje te drejte te mohuar ose te cenuar prej dikuj tjetër.

Referuar rastit ne gjykim rezulton se, ne lidhje me aplikimin e bere nga shoqeria {...} sh.p.k, per regjistrimin e markes {...} ne perputhje me nenet 143 dhe 152 te ligjit nr. 9947 "Per pronesine industriale" te ndryshuar, shoqeria {...}S.P.A, ka paraqitur kundershtim prane Dhomes per Shqyrtimin e Kundershtimeve te DPPP-se, e cila eshte mbajtese e markes "{...} S CAFFE ESPRESSO IN ITALY", duke pretenduar nder te tjera se marka per te cilen kerkohet regjistrimi, eshte e ngjashme me marken e regjistruar, dhe duke qene se behet fjale per te njejtat mallra ato shkaktojne konfuzion te konsumatoret.

Ne perfundim te procedures administrative, si dhe pas shqyrtimit te pretendimeve perkatese te paleve, Dhoma per Shqyrtimin e Kundershtimeve me vendimin nr.145/9 prot., date 03.06.2020, ka vendosur: Pranimin e kundershtimit te regjistrimit te markes {...} me numer aplikimi AL-T-2019-145, me aplikant {...} sh.p.k, dhe refuzimin e regjistrimit te saj, vendim ky i cili eshte lene ne

fuqi nga Bordi i Apelimit prane DPPI-se, me vendimin nr.145/7 prot., date 04.03.2021.

Sa me siper, ne baze te nenit 32/a dhe 15/a te ligjit nr. 49/2012, paditesi legjitimohet per t iu drejtuar gjykates per te kundershuar aktet administrative objekt gjykimi, per te kerkuar rivendosjen e se drejtes se saj te pretenduar si te cenuar apo mohuar nga pala e paditur, pasi aktet administrative te sipercituar, kane cenuar te drejten e saj qe rrjedhin nga pronesia industriale.

Po ashtu pala e paditur, Drejtoria e Pergjithshme e Pronesise Industriale, ka legjitimitet pasiv ne kete gjykim, pasi aktet administrative objekt kundershimi gjyqesor jane nxjerre nga ky organ i administrates publike.

Ne lidhje me themelin e geshtjes:

Ne lidhje me sa u pretendua nga ana e paleve ne kete gjykim, gjykata, referuar rrethanave te faktit, provave te shqyrtuara ne seance gjyqesore si dhe shkakut ligjore te padise, gmon se kerkimet e pales paditese jane te pabazuara ne ligj e ne prova dhe se kerkesepadia e paraqitur prej saj duhet rrezuar, duke arsyetuar si me poshte:

Sipas nenit 143, pika 2, germa "b" te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "*Per pronesine industriale*" te ndryshuar (*Refuzimi per shkaqe relative*) "*Marka nuk mund te regjistrohet ose, nese eshte regjistruar, ajo duhet te deklarohet e pavlefshme kur*":

b) *eshte e njejte ose e ngjashme me nje marke te meparshme, e cila mbrohet per mallra apo sherbime identike ose te ngjashme dhe kur, per shkak te njelloshmerise ose te ngjashmerise, ekziston mundesia e shkakimit te konfuzionit te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes me marken e meparshme;*

Nga permbajtja e kesaj dispozite, rezulton se nje marke nuk mund te regjistrohet nese plotesohen ne menyre kumulative tre elemente si:

1. *marka qe kundershohet duhet te jete e njejte ose e ngjashme me marken e meparshme;*
2. *marka qe kundershohet kerkon mbrojtje per te njetat mallra ose sherbime, ose per mallra apo sherbime te ngjashme me ato per te cilat eshte mbrojtur marka e meparshme;*
3. *ngjashmeria e markes qe kundershohet dhe markes se meparshme eshte e tille qe shkakton konfuzion te publiku, ose sjell si pasoje bashkelidhjen mes markave.*

Ne analizimin e elementeve te mesiperm, Gjykata konstaton se, marka "{...} ESPRESSO IN ITALY" e regjistruar ne emer te shoqerise "{...}" S.P.A, gezon te drejta te meparshme ne kuptim te nenit 143, pika 5, germa "a" dhe "b" te ligjit nr.9947 date 07.07.2008 "*Per pronesine industriale*" te ndryshuar, per shkak te regjistrimit te meparshem.

Keshtu, sipas pikes 5, germa "a" dhe "b" te nenit 143 te ligjit te sipercituar, "*Marke e meparshme, ne kuptim te pikes 2 te ketij neni, vleresohet*":

a) *marka, me nje date aplikimi per regjistrim me te hershme sesa data e aplikimit per regjistrim e nje marke tjeter tregtare, duke pasur parasysh, kur eshte rasti, pretendimin per prioritet per ate marke, sipas nenit 147 te ketij ligji;*

b) *marka, qe eshte regjistruar me pare, nepermjet nje marreveshjeje nderkombetare, ne te cilen Republika e Shqiperise eshte pale;* Kjo marke eshte regjistruar ne Zyren Nderkombetare te Organizates Boterore te Pronesise Industriale dhe mbrojtja e saj eshte e shtrire ne Shqiperi ne baze te Protokollit te Madridit per Regjistrimin Nderkombetar te Markave, i ratifikuar me ligjin nr. 8992, date 30.01.2003 "*Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Protokollin e Marreveshjes se Madridit per Regjistrimin Nderkombetar te Markave*" dhe si i tille ai eshte bere pjese e legjislacionit shqiptar.

Ne analize te elementeve te parashikuar nga neni 143, pika 2, germa "b" te ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "*Per pronesine industriale*" te ndryshuar, te sipercituar, Gjykata, gmon se diskutimi duhet fokusuar ne tre geshtje kryesore:

- a) *ngjashmerine mes markave;*
- b) *ngjashmerine mes mallrave per te cilat mbrohen markat; dhe*
- c) *ekzistenca e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje midis markave per shkak te ngjashmerise.*

a) Ngjashmeria midis markave.

Analiza e krahasimit te markave ne konflikt duhet bere duke u bazuar mbi teresine e elementeve perberes te markave dhe ne pershtypjen e pergjithshme qe shkaktojne ato tek konsumatori, duke u fokusuar ne elementet dominant dhe dallues te markes.

- Nga pikepamja vizuale.

Referuar rastit ne gjykim, Gjykata konstaton se marka kundershuese dhe ajo e kundershuar, jane vizualisht te ngjashme per arsye se elementet perberes te tyre jane te ngjashem, kjo pasi marka e kundershuar perbehet nga paraqitja ne menyre te stilizuar e elementit literal {...} e shkruar me germa ne ngjyre te bardhe. Ne pjesen e poshteme te saj paraqitet elementi grafik i stilizuar i nje filxhani kafeje dhe te kokrrave te kafese. E gjitha marka konsiston ne formen e paketimit te nje qeseje kafeje.

Marka kundershuese perbehet nga paraqitja ne menyre te stilizuar e elementit literal {...}e shkruar me germa ne ngjyre te bardhe te vendosura brenda figures se nje elipsi. Ne pjesen e fundit te saj jane paraqitur ne menyre te stilizuar elemeti literal {...} te shkruajtura me ngjyre te bardhe.

Per sa me siper, elementet literal te markes se kundershuar dhe lementet literal te markes kundershuese, jane vizualisht shume te ngjashme e cila konsiston ne menyren e stilizimit dhe paraqitjes se tyre. Gjithashtu, karakteri dallues i markave ne diskutim qendron tek elementi verbal ESSSE vs. {...}. Per shkak se markat ne konflikt operojne ne fushen e kafes dhe te produkteve me baze kafe, elementet figure si kokrrat e kafese, filxhani i kafes, silueta e aromes se kafese qe ndodhen tek aplikimi i kundershuar, apo fjalet CAFFE, ESPRESSO IN ITALY tek marka e meparshme, jane element te dobet te markave pasi ato jane te nje natyre pershkruese. Elementi dominant dhe dallues i markave eshte elementi literal {...} dhe "Essse", te cilet perbejne elementin e vetem dominant te markave ne fjale, pasi raporti i tyre tek marka/shenja respektive (ne krahasim me element te tjere) eshte me i madh dhe keto element pothuajse gjenden ne qender te markave.. Per kete arsye, analiza e ngjashmerise ndermjet markave do te realizohet dhe bazohet vetem mbi kete element.

Nga ana vizuale, markat objekt krahasimi jane te ngjashme midis tyre. Keshtu, te dy markat ne konflikt permbajne tre germa identike te cilat jane vendosur sipas te njejtir rend {...}dhe {...}. Ivetmi ndryshim eshte ne fund te tyre, por ky ndryshim eshte tejet i vogel dhe i paperfillshem ne pershtypjen e pergjithshme qe keto marka shkaktojne tek konsumatori. Per pasoje markat ne shqyrtim vleresohen si vizualisht te ngjashme.

- Nga pikepamja fonetike.

Po ashtu, ne analize te elementeve te parashikuar nga neni 143, pika 2, germa "b" te ligjit nr.9947, date 07.07.2008 "*Perpronesine intelektuale*" te ndryshuar, te sipercituar, Gjykata konstaton se, ne aspektin *fonetik*, markat jane te ngjashme per te mos thene identike. Kjo ngjashmeri rezulton nga ngjashmeria midis shkronjave, por edhe ne teresine e shqiptimit/tingellimit/degjimit ndermjet tyre. Diferenca e vetme ne shqiptim {...} vs. {...} Caffe, mund te mos vihet re pasi ato jane te dyja zanore te perparme, shqiptimi i te cilave kerkon te njejtin impenjim te gjuhes, p.sh, trupi i gjuhes shtyhet perpara, ndersa pjesa e mesme e shpines se gjyhes ngrihet drejt qiellzes se forte. Per me teper, ato humbasin ne morine e shkronjave qe shenjat/markat kane {...} vs. {...} Caffe. Vlen te theksohet se aspekti fonetik merr nje rendesi te vegante po te mbajme parasysh menyren e tregtimit te produkteve ne diskutim. Kafeja ne pergjithesi konsumohet ne bare kafe, ku porositet duke u thirrur dhe jo duke u shkruar. E ne nje suate te tille porosia per nje ekspres {...} lehtesisht mund te ngaterrohet me nje {...} Caffe. Gjykata deshiron te theksoje se shqiptimi i markave luan nje rol te rendesishem ne dallueshmerine e markave, pasi konsumatorët perqendrohen tek fjala dhe



shqiptimi i saj. Per pasoje Gjykata gmon se markat ne konflikt kane ngjashmeri te larte fonetike.

- Nga pikepamja konceptuale.

Sa i perket ngjashmerise se markave ne aspektin konceptual, Dhoma me te drejte ka vlersuar se markat nuk percjellin ndonje kuptim tek konsumatori, pasi {...} dhe {...} *caffè*, jane bashkime arbitrare shkronjash, keshtu qe krahasimi konceptual nuk merr rendesi. Ne rastin ne diskutim, elementet verbal {...} vs dhe {...} nuk kane ndonje kuptim te caktuar, nuk gjenden as ne fjalor apo enciklopedi, per pasoje nuk mbartin ndonje kuptim te caktuar. Elementet literal te te dyja markave jane fjale te cilat ne gjuhen shqipe apo te perkthyer ne gjuhen shqipe, nuk mbartin ndonje kuptim te vegante, ndaj ato nuk mund te krahasohen konceptualisht.

*b) Ngjashmeria ndermjet mallrave per te cilat mbrohet markat ne konflikt:*

Ne lidhje me ngjashmerine e mallrave, referuar rastit ne gjykim, rezulton se marka e kundershuar {...} kerkon te mbrohet per mallra e klasave 30 dhe 35 te Klasifikimit Nderkombetar te Nises, per te cilat tashme eshte regjistruar marka kundershuese {...}, pasi rezulton se markat ne konflikt mbulojne pikerisht keto mallra, me perjashtim te markes kundershuese qe mbullon dhe klasen 43. Mallrat dhe sherbimet ne rastin ne diskutim jane identike. Ato koingidojne ne termat si; kafe artificiale, sherbime te shitjes me pakice te kafese dhe kafese artificiale etj., g'ka i ben ato identike.

*c) Ekzistenca e mundesise qe te shkaktohet konfuzion tek konsumatori ose bashkelidhje midis markave per shkak te ngjashmerise.*

Duke u bazuar ne analizen e mesiperme te detajuar te ngjashmerise, Gjykata gmon se ekziston nje ngjashmeri e mjaftueshme ndermjet markes se kundershuar dhe markes se kundershuese/meparshme, e tille qe te sjelle mundesine e konfuzionit ose bashkelidhjes se tyre nga konsumatori.

Ne vlersimin e mundesise per konfuzion duhet mbajtur parasysh edhe shkalla e vemendjes se konsumatorit, mesatare e cila mund te ndryshoje ne varesi te mallrave dhe sherbimeve qe markat mbulojne. Ne qofte se ka nje nivel te vogel vemendje, ndryshimet midis markave padyshim nuk do te dallohen nga konsumatori, kjo per shkak te memorjes joprefekte te konsumatoreve. Anasjelltas, nje shkalle e larte vemendje do te minimizonte mundesine per konfuzion, pasi konsumatori per shkak te vemendjes do te diferenconte markat.

Ne pergjithesi, nje shkalle e ulet vemendje eshte e lidhur ne menyre te vegante me zakonin e te berit Pazar. Vendimet e blerjeve ne kete fushe kane te bejne me, mallra te lira te blera ne baza ditore. Kafaja dhe produktet me baze kafeje jane produkte qe konsumohen vazhdimisht dhe hyjne ne kategorine e produkteve me gmime te lira. Vendimi per blerjen/konsumin e tyre merret shpejt. E gjithë kjo rezulton ne nje shkalle te ulet vemendje e cila padyshim do te kntribuojë ne krijimin e konfuzionit, pasi ndryshimet/diferencat mes markave padyshim nuk do te dallohen nga konsumatori perkates.

Karakter i theksuar dallues i markes se meparshme eshte nje tjetër element qe mbahet parasysh ne vlersimin e mundesise per konfuzion. Produktet e {...} tregtohen per nje kohe te gjate ne tregun shqiptar. {...} pa diskutim ka fituar karakter te theksuar dallues per shkak te emrit te mire dhe prezences se saj te gjate ne tregun shqiptar. Ky eshte nje tjetër faktor qe kontribuon ne mundesine per konfuzion. Per te mos mbetur vetem tek mundesi per konfuzion, qe gjithsesi perben baze te mjaftueshme per te refuzuar regjistrimin e markes se kundershuar, ne rastin ne gjykim prezente eshte gjithashtu dhe mundesia e bashkelidhjes se markave, nje shkak tjetër ligjor i parashikuar nga neni 143/2, germa "b" i ligjit specifik. Ne doktrinen e markave ky lloj konfuzioni ka te beje me origjinen tregtare te mallrave te cilat mbuloohen nga markat. Ky eshte rasti kur pronari i markes se kundershuar mund te preceptohet si i ligencuari/distributor i pronarit te markave kundershuese, apo mund te preceptohet si dege e kompanise (meme) te pronarit te markave kundershuese.

Ne rastin ne gjykim, duke mbajtur parasysh se markat perkajne ne karakteret e tyre dalluese *Essse vs. {...}*, konsumatorët do t'i preceptojne markat si zgjatim te njera-tjetres, si marka/produkte qe derivojne nga e njejta familje markash. Dhe e gjitha kjo do te rezultojë ne ngaterrimin e origjines tregtare te produktit pasi konsumatorët do te mendojne qe produktet vijne nga e njejta siper marrje apo siper marrjet jane te lidhura me njera-tjetren. Per sa me siper, mundesia e bashkelidhjes se markes apo sig quhet ndryshe konfuzioni ne lidhje me origjinen tregtare ketu eshte prezent.

Per sa me siper, me te drejte nga Dhoma per Shqyrtimin e Kundershimeve dhe Bordi i Apelimit prane DPPI-se, me aktet administrative objekt gjykimi eshte vendosur refuzimi i regjistrimit te markes me Nr. Aplikimi AL/T/2019/145, pasi shkel te drejtat e meparshme te markes kundershuese ne kuptim te nenit 143 te ligjit nr. 9947, date 07.07.2008 "*Per pronesine industriale*" te ndryshuar.

Lidhur me pretendimet e pales paditese, Bordi i Apelimit ka perfunduar proceduren administrative pa vendosur per te gjitha geshtjet e ngritura nga palet gjate procedures dhe qe nuk kane marre zgjidhje gjate tij, Gjykata i gmon te pabazuara, pasi geshtjet e ngritura ne apelim nga pala paditese kane qene te njejta me ato parashtruara perpara Dhomes per Shqyrtimin e Kundershimeve, ku kjo e fundit ne vendimin e saj i ka dhene zgjidhje te gjitha geshtjeve qe jane ngritur nga palet ne konflikt. Ne keto rrethana, Bordi i Apelimit ne vendimin e tij, nuk ka bere gje tjetër vegse e ka konfirmuar vendimin e Dhomes, per te gjitha geshtjet e ngritura nga palet, si ajo kundershuese ashtu dhe nga pala e kundershuar, dhe analiza edhe njehere e te gjitha geshtjeve te ngritura per te cilat kane marre zgjidhje ne vendimin e Dhomes, do te ishte pa sens llogjik.

Po ashtu, ne lidhje me pretendimin tjetër te pales paditese se Dhoma dhe Bordi i Apelimit kane pranuar si te vlefshme provat e paraqitura ne gjuhe te huaj nga personi i trete gjate procedurave administrative, Gjykata e gjen me vend te theksoje se paraqitja e ketyre provave me se shumti ka qene e lidhur me te provuarin e perdorimit te markes dhe tregtimit ne Shqiperi i produkteve nen marken {...}, g'ka nuk eshte thelbesore per geshtjen.

Shkaku ligjor baze mbi te cilein eshte mbeshtetur kundershimi ndaj markes {...} ka qene mundesia per konfuzion. Ky shkak ligjor nuk kerkon te provuarit detyrimisht te perdorimit te markes ne territorin shqiptar, sipas nenit 143/2, germa "b" te ligjit nr.9947/2008, i ndryshuar. Mundesia per konfuzion ekziston kur permbushen njekohesisht dy kushte:

- 1) *Ngjashmeria mes shenjave, duke mbajtur parasysh karakterin dallues dhe dominant te tyre;*
- 2) *Ngjashmeria mes mallrave/sherbimeve.*

Te provuarit e ketyre dy kushteve, nuk eshte e lidhur me te provuarit e perdorimit te markes ne territorin shqiptar. Perdorimi i markes ne treg eshte thjeshte nje element shtese/dytesor i cili mund te kontribuojë ne krijimin e konfuzionit, gjithsesi nuk eshte element qe kerkohet detyrimisht te permbushet nga ligji.

Gjithsesi, Gjykata vleron se shkresa nr.495/1 prot., date 21.01.2020 leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, si dhe flete nga bilanci i shkembimeve tregtare te mbajtura nder vite, te paraqitura nga kundershuesi (person i trete ne kete gjykim), ne proceduren e hetimit administrativ, jane ne formen e kerkuar nga ligji, dhe si te tilla ata kane vlere provuese ne veshtrim te nenit 246 dhe 253 te K.Pr.Civile, pasi ata jane te hartuara ne gjuhen shqipe dhe jane perpiluar nga nepunesi i shtetit ose personi qe ushtron veprimtari publike, brenda kufijve te kompetences se tyre.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e paditesit se aplikanti ka formuar familjen e markave {...}, e cila eshte pjese e emrit tregtar te regjistruar ne Kosove, dhe rregullat per etiketimet parashikojne vendosjen e emrit te pronarit ne etikete, duke iu referuar per kete nenit 8 i Konventes se Parisit date 20 Mars 1883 "*Per mbrojtjen e proneses industriale*" qe parashikon mbrojtje per emrat tregtare, Gjyakta deshiron te theksoje se Konventa e Parisit aplikohet mes vendeve anetare te Bashkimit Evropian, ne te cilin Kosova nuk ben

pjesë. Duke mos qene pjesë e Bashkimit/Unionit, Kosova, e per rrjedhoje te gjithë subjektet tregtare te themeluara ne baze te ligjeve te Kosoves nuk e gezojne kete te drejte. Pra, neni 8 i Konventes se Parisit nuk eshte i aplikueshem ne rastin konkret.

Edhe sikur ta prananim per nje moment se Konventa e Parisit gjen zbatim ne rastin konkret, marka e kundershtuesit (personit te trete ne kete gjykim) mbetet po perseri e drejte e meparshme dhe ndaj emrit tragtar {...} ne Kosove, pasi kjo marke eshte e regjistruar ne Shqiperi qe prej dates 21.03.2014 dhe prezente ne tregun shqiptar qe prej vitit 2007, ndersa emri tregtar {...} figuron i regjistruar ne Kosove vetem me 08.10.2014, pra 7 (shtate) muaj me vone. Ne keet menyre, marka e kundershtuesit figuron e drejte e meparshme dhe ndaj regjistrimit te emrit tregtar {...} ne Kosove.

Perfundimisht, nga sa u analizua me siper, Gjykata arrin ne perfundimin se kerkesepadia e paraqitur nga pala paditese, shoqeria {...} sh.p.k, duhet rrezuar teresisht, si e pabazuar ne ligj e ne prova.

### Per keto arsye

Gjykata, bazuar ne nenet 126, 306 te K.Pr.Civile, si dhe nenin 40/3 te ligjit nr.49/2012 "Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative" te ndryshuar.

### VENDOSI:

#### Vendosi:

- ~~€€€€€€€€~~ Rrezimin e kerkeses padise se paraqitur nga pala paditese shoqeria {...} sh.p.k, si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova. •~~€€€€€€€€~~ Shpenzimet gjyqesore lihen ne ngarkim te pales paditese.
- ~~€€€€€€€€~~ Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Administrative te Apelit Tirane duke filluar nga e nesermja e njoftimit te vendimit te arsyetuar.
- ~~€€€€€€€€~~ U shpall ne Tirane sot me date 28.09.2021.

### SHPENZIMET GJYQESORE

Kerkesepadia	0
Taksa Gjyqesore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

### GJYQTAR:

{...}